



CB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKENr. 5693 prot.Vlorë, më 24.03 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

“ Për një shtesë në VKB Nr.46 datë 29.05.2024" Mbi miratimin e vendqëndrimeve të autoveturave taksi në Bashkinë Vlorë dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi”

Këshilli i bashkisë i mbledhur sot me datën _____ 2024, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”, kreu VII, neni 23, pika 6, Ligjit Nr.8308 datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar kreu II.4, neni 35, Ligjit 8378 datë 22.07.1998”Kodi rrugor i RSH”, neni 85, pika 3 , Udhëzimit Nr.1649 date 16.08.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve” ndryshuar, kreu III, pika 3 , udhëzimi Nr. 15 datë 24.7.2007”Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave , autorizimet dhe çertifikatat për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, kreu III, neni 8/pika 1, neni 9/pika 3, kreu VI, neni 21, kërkesës së Sindikatës së Pavaruar të taksistëve, kërkesës së subjekteve të cilët kryejnë këtë shërbim si dhe propozimin e Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike lidhur me kriteret për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi :

VENDOSI :**I-Të miratojë kriteret shtesë në shërbimin taksi në Bashkinë Vlorë si më poshtë:**

Pas pikës (d) të shtohet :

e)- Subjektet që janë të licensuara nga Bashkia Vlorë për transport udhëtarësh me taksi me mjete taksi 4+1 dhe 8+1 dhe ushtrojnë aktivitetin në shërbimin taksi, por që nuk plotësojnë kushtin që do të rilicencohen vetëm kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet dhe afati i licencës ju përfundon në vitin 2026, 2027, do të rilicencohen me afat dy vjeçar, me të drejtë rinovimi të mjetit ku mosha e mjetit të jetë jo më shumë se 15 vjeçare.

f)- Në rastin e tërheqjes të licencës nga Policia Rrugore, për shkelje të kushteve të vendosura në licencë, dhe dërgimi i saj pranë autoritetit që e ka lëshuar, ndaj subjektit do të ndiqen këto masa:

1- Njoftim për tërheqje vëmendje dhe marrje masash për mos përsëritje të shkeljes së kushteve të licencës.

2- Në rast përsëritje pezullohet licenca për 1(një) muaj, nga data e tërheqjes së licencës.

3- Në rast përsëritje të pikës f/2 pezullohet licenca për 3(tre) muaj, nga data e tërheqjes së licencës

4- Pas ezaurimit të tre pikave të mësipërme, të hiqet licenca.

- Subjektet të cilët do tu hiqet licenca nuk mund të rilicensohet para afatit 1 vjeçar nga data e heqjes së licencës dhe moshë e mjetit duhet të jetë jo më shumë se 10-vjeçare.

II- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.

III- Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

“ Për një shtesë në VKB Nr.46 datë 29.05.2024" Mbi miratimin e vendqëndrimeve të autoveturave taksi në Bashkinë Vlorë dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi”

Mbështetur në Ligjit Nr.8308 datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar kreu II.4, neni 35; Ligjit 8378 datë 22.07.1998”Kodi rrugor i RSH”, kreu II.4, neni 35; , Udhëzimit Nr.1649 datë 16.08.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar” këshilli i bashkisë përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtij shërbimi brenda territorit të vet si dhe vendqëndrimet e mjeteve taksi”, kreu III, pika 3; Udhëzimi Nr. 15 datë 24.7.2007”Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave , autorizimet dhe çertifikatat për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, kreu III, neni 8/pika 1, neni 9/pika 3, kreu VI, neni 21, si dhe të kërkesës së Sindikatës së Pavaruar të taksistëve dhe të vetë subjekteve të cilët kryejnë këtë shërbim me mjete taksi 4+1 dhe 8+1, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ka përgatitur një shtesë në VKB Nr.46 datë 29.05.2024, lidhur me shtesë të kriterëve për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi :

e).Në VKB Nr.46 datë 29.05.2024,"Mbi miratimin e vendqëndrimeve të autoveturave taksi në Bashkinë Vlorë dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi", janë të miratuara vendqëndrimet e autoveturave taksi në qytetin e Vlorës si dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi.

Sipas kësaj VKB për subjektet fizike që janë të licensuara nga bashkia dhe ushtrojnë aktivitetin transport udhëtarësh me taksi 4+1 dhe 8+1, rilicensimi i tyre do të bëhet kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet, në rast të mos plotësimit të kushtit të mësipërm dhe afati i licencës përfundonte në 2024, 2025 do të rilicensohen me afat 2 vjecar, me të drejtë rinovimi të mjetit.

Në Bashkinë Vlorë më datë 17.02.2026 është organizuar një takim me përfaqësues të Sindikatës së Pavaruar të Taksistëve 4+1, u analizuan të gjitha shqetësimet dhe problematikat e subjekteve, me qëllim që të luftohet informaliteti, taksitë pirate, ndryshimi i vitit të prodhimit. Këto shqetësime dhe problematika ata i kanë paraqitur me shkresën Nr.3998 prot. datë 26.02.2026.

Në lidhje me konsultimin me grupet e interesit me përfaqësues të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në shërbimin taksi 4+1 dhe 8+1 është organizuar përsëri një takim me Kryetaren e Bashkisë më datë 17.03.2026, me qëllim propozime dhe diskutime për tu ardhur në ndihmë këtyre subjekteve.

Shqetësimi i subjekteve që kryejnë transport udhëtarësh me taksi 4+1 dhe 8+1 dhe u përfundon afati i licencës në vitin 2026, 2027, ishte që në momentin e rilicensimit mosha e mjeteve të tyre është më shumë se 15 vjet.

-Subjekte me taksi 4+1 që u përfundon licenca në vitin 2026 , 2027 dhe nuk plotësojnë kushtin që në momentin e rinovimit të licencës mosha e mjetit është me shumë se 15 vjet janë 54.

-Subjekte me taksi 8+1 që u përfundon licenca në vitin 2026 , 2027 dhe nuk plotësojnë kushtin që në momentin e rinovimit të licencës mosha e mjetit është me shumë se 15 vjet janë 10.

DIIP duke qënë se këta subjekte kanë qënë të licensuar para daljes së VKB Nr.46 datë 29.05.2024, nuk kanë qënë të njohur me këtë kusht dhe për arsye të vështirësive ekonomike për të rinovuar mjetin, propozojmë që për mjetet taksi 4+1 dhe 8+1 që janë të licencuara nga bashkia dhe licenca i përfundon në vitet 2026, 2027, por nuk e plotësojnë kushtin që mosha e mjetit të jetë jo më shumë se 15 vjet, të rilicensohen me afat dy vjeçar, me të drejtë rinovimi të mjetit.

f).Në bazë të Udhëzimit Nr. 15 datë 24.7.2007”Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave , autorizimet dhe çertifikatat për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, kreu III, neni 8/pika 1, neni 9/pika 3, kreu VI, neni 21:

--*Liçenca/ autorizimi/ çertifikata hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:*

- *Subjekti transportues i liçencuar nuk i plotëson më kushtet e nenit 8, (Reputacioni i mirë, Kompetenca Profesionale, Gjendje e Përshtatshme Financiare dhe Zotërimi i mjeteve të transportit rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar);*

- *Subjekti transportues e transferon liçencën/ autorizimin/ çertifikatën e tij, tek një Tjetër.*

Nga Drejtoritë e Policisë pranë Bashkisë Vlorë dërgohen licencat e subjekteve të cilët kryejnë transport udhëtarësh brenda vendit me taksi 4+1 dhe 8+1, duke shkelur kushtet e licencës. Në këto kushte DIIP paraqet në Këshillin Bashkisë propozimet për pezullimin dhe heqjen e licencës sipas rasteve.

Duke u nisur nga sa më sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkisë që të bëhet miratimi i këtij projektvendimi, për tu ardhur në ndihmë subjekteve që kryejnë transport me taksi 4+1 dhe 8+1, duke u dhënë ndihmë subjekteve për të rinovuar mjetet sipas legjislacionit në fuqi.


KRYETAR
Brunilda Mersini